



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJORË MAT

Vendim

Nr. 10 datë 26/07/2018

"Për

miratim të Lejes së Përdorimit të Ujit për prodhim të energjisë elektrike, nëpërmjet ndërtimit të Hidrocentralit "DOMA" në Lumin Mat, në Njësia Administrative Suç, Bashkia Klos, Qarku Dibër, Subjektit "Global Interprise Group" shpk".

- Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 51 dhe nenit 52 të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" të ndryshuar, vendimin nr.416 datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe Leje për përdorim të burimeve ujore", nenit 24 të Vendimit të KM nr. 822, date 07.10.2015, "Per miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni", **si dhe miratimit paraprak nr. 2252/4 datë 29/05/2017 të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, miratimin në parim nga KBU Mat me nr. 36 dt. 22.09.2017**, me propozim të A.B.U. Mat, Këshilli i Basenit Ujor Mat;

Vendosi:

1. Miratimin e "Lejes për Përdorim të Rezervave Ujore për prodhimin e energjisë elektrike", Subjektit "Global Interprise Group" sh.p.k, me Administrator Z.Ashim Doma, **me këto të dhëna:**

-Përroi i i Lusës degë e Lumit Mat , Bashkia Klos , Qarku Dibër, **subjektit "Global Interprise Group" shpk. Hec "DOMA"**

-Vepra e Marrjes

-Prurja mesatare : $Q_{mes} = 0.7 m^3/sek$,

-Prurja llogarites: $Q_{llog} = 0.9 m^3/sek$,

-Prurja ekologjike: $Q_{ekol} = 0.09 m^3/sek$,

-Prurje për përdorime të tjera: _____ m^3

-Kuota e vepres së marrjes $Z = 494.5 m$ X - 44 26 602 Y- 46 03 377

-Kuota e godines së centralit: $Z = 255.8 m$ X - 44 22 745 Y- 46 07 346

-Fuqia 1 695kë/ore ;3657pune/vit

-Energjia e planifikuar vjetore: 6 198 759 këh/vit

2- **Nuk lejohet ndryshimi i regjimit të vaditjes, i furnizimit me ujë të popullatës etjerë nga përdorimi i ujit për energji elektrike.**

3. **Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

PËRGJEGJËSI I A.B.U. MAT

Bujar SHPENDI



KRYETARI I K.B.U. MAT

Gjergj PRENDI

